

ÇFARË NDIKIMI DO TË KETË BASHKIMI ISLAMIK NË ZHVILLIMIN EKONOMIK



Politikat bashkëkohore botërore, i detyrojnë popujt të integrohen në bashkësi ndërkombëtare në interes të sigurisë dhe ekonomisë së vetë kombit. Në këto bashkësi ndërkombëtare, të cilat zakonisht bazohen në lokacione gjeografike, faktorët si resurset natyrore, blloqet tregtare, madje edhe vlerat kulturore luajnë një rol të rëndësishëm. Shumë shtete fqinje i bashkojnë resurset e tyre nën organizata të tilla, krijojnë aleanca mbrojtëse, si dhe bashkëpunojnë në rrafshë çështjesh të shumta. Qëllimi i bashkësive të tilla është të ruaj paqen, të kontrolloj garën në armatim, të zgjidhë mosmarrëveshjet me anë të diplomacisë, të promovojë zhvillimin socio-ekonomik si dhe të mbrojnë të drejtat themelore dhe demokracitë e njeriut. Aktualisht NATO, OSCE si dhe EU, NAFTA, OPEC, ASEAN, G-8, D-8 dhe APEC janë bashkësitë politike,

ushtarake dhe ekonomike kryesore ndërkombëtare.

Këto institucione janë temë për reformat organizative për arsye të anëtarëve të ri ose të zgjerimit të kufijve. Që të gjitha këto organizata, të formuara pas Luftës së Dytë Botërore, kanë kontribuar në krijimin e stabilitetit dhe rendit në botë si dhe kanë luajtur një rolë të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik global. Shtetet anëtare i mbrojnë interesat e tyre ekonomike dhe ushtarake, si edhe sigurojnë pozitë më të fuqishme regjionale e ndërkombëtare. Edhe bota e zhvilluar e kupton nevojën e partneritetit të tillë. Krijimi i zonave të lira tregtare, marrëveshjet regjionale tregtare, heqja e kontrolleve doganore, si dhe monedha e përbashkët (si në BE) sigurojnë të ardhmen e shteteve anëtare. Paktet mbrojtëse ua mundësojnë shteteve anëtare të ulin harxhimet ushtarake si dhe ti drejtojnë ato resurse në fushën kulturore e arsimore.

Një organizim i ngjashëm do të ofronte përfitime të konsiderueshme për popujt Mysliman. Për ata të cilët janë të dëshpëruar lidhur me zhvillimet teknologjike si dhe ato ekonomike, hapi i parë drejtë stabilitetit është krijimi i një organizate ose, me fjalë të tjera, një botë e bashkuar Islamike nën ombrellën e Unionit Islamik.

Zhvillimi ekonomik dhe ngritja e mirëqenies

Bashkëpunimi ekonomik është mase i nevojshëm për dy arsye: stabilitetit dhe zhvillimit. Popujt mysliiman duhet të sjellin stabilitet dhe soliditet ekonomike të tyre. Zhvillim i industrive si dhe investimet e nevojshme janë jetësore, siç është edhe nevoja për një planë zhvillimor gjithëpërfshirës si dhe zhvillimin e vazhdueshëm të arsimit, ekonomisë, kulturës, shkencës dhe teknologjisë. Derisa sektorët e ndryshëm të janë zhvilluar teknologjikisht, niveli i forcave punuese të arsimuara dhe standardet duhet të jenë ngritur në mënyrën e duhur. Shoqëria duhet të motivohet që të jetë më produktive dhe ku bashkëpunimi i përfituar ekonomik të luaj një rolë vendimtarë në zhdukjen e varfërisë, analfabetizmit, ndarjes jo të drejtë të pasurisë si dhe problemeve tjera socio-ekonomike të trazuara në vendet Myslimane. Ky partneritet mund të formohet vetëm me anë të krijimit të zonave të lira tregtare, bashkësive doganore, dhe të fushave të përbashkëta ekonomike.

Shumica e vendeve Myslimane kanë rëndësi gjeostrategjike si dhe burime të pasura natyrore (p.sh., gaz natyral dhe vajë të papërpunuar). Këto burime dhe mundësi strategjike, megjithatë, nuk po shfrytëzohen në mënyrë efektive. Në botën Islamike 86% e standardit të jetës së banorëve bie nën \$ 2,000, 76% nën \$ 1,000, dhe 67% nën \$500 dollar në vit. Kur merren parasysh burimet e përgjithshme të botës Islamike (1) ky është vërtet një paradoks: Afërsisht gjysma e naftës së konsumuar në Perëndim eksportohet nga bota Islamike, siç është edhe 40% e prodhimeve bujqësore. (2) Shumë ekonomistë dhe strategë lirshëm e pranojnë se ekonomia botërore varët nga eksporti i vajit dhe gazit nga bota Islamike, në veçanti nga ato të Gjirit Persian. (3)

Gjiri Persian mbanë dy të tretat e rezervave të papërpunuar të naftës së zbuluara në planet. Të dhënat e siguruar nga hulumtimi kanë nxjerrë në pah se vetëm Arabia Saudite mbanë 25.4% të rezervave botërore, ose 262 bilion barela. 11% tjera gjinden në Irak, 9.6% në EBA, 9.2% në Kuvajt, 8.6% në Iran, 13% në shtetet tjera anëtare të OPEC. Kurse tjetra pjesë është në vendet tjera të botës. (4) Hulumtimi nga ana e Departamenti të Energjisë nga SHBA-të tregojnë se brenda vitit 2000 dhe 2020, eksportimi i naftës nga rajoni do të rritet deri në 125%. (5) Kjo nënkupton se bota do të vazhdojë të përmbush nevojat e saja energjike me anë të importit nga rejoni i Gjirit. Për më tepër, Lindja e Mesme ka 40% të rezervave botërore të gazit natyral; 35% e këtyre rezervave janë në regjionin e Gjirit. (6) Algjeria, Libia dhe vendet tjera të Afrikës Veriore kanë 3.7% të rezervave botërore.



Kaukazi dhe Azia Qendrore gjithashtu janë të pasura me naftë, gazë natyral, dhe burime tjera natyrore. Për shembull, Kazakistani ka diku në mes 10-17.6 bilion barela të rezervave të vërtetuara të naftës, derisa rezervat e saja të gazit natyral llogariten të jenë në mes 53 dhe 83 trilion kubik. Turkmenistani ka në mes 98 dhe 155 trilion kubik gazë rezerva natyrore, duke e pozicionuar atë si prodhuesin e katërt me të madh. (7) Disa vende tjera Myslimane kanë burime të çmueshme mineralesh. Për shembull, Uzbekistani dhe Kirgistani janë dy prodhues ari që prijnë në botë. Turqia ka një rëndësi ndërmjet rezervatet më të pasura të borit në botë, vetë së fundi është zbuluar që është shumë i rëndësishëm, ndërsa Taxhikistani ka pajisjet më të mëdha në botë të prodhimit të aluminit.

Këto përparësi do të bëhen edhe më të rëndësishme gjatë shekullit njëzetë e një, të cilin tanimë disa e kanë pagëzuar si "shekulli i energjisë". Energjia është element themelor i shoqërisë moderne në lidhje me ushtrinë, industrinë, urbanizimin dhe transportin. Duke ditur që aktivitetet ekonomike dhe prodhimtaria varën kryesisht nga energjia, popujt do të bëjnë çka është e mundur për të futur nën kontroll këto burime të energjisë. Bota Islamike nuk është duke i shfrytëzuar burimet e saja në mënyrë efektive, shumë prej pjesëtarëve të saj u mungon infrastruktura dhe teknologjia që ta ngritë prodhimin dhe të shfrytëzojë burimet natyrore për të zhvilluar industrinë e tyre. Prandaj, kontributi i burimeve në favor të ekonomisë së vendit është i limituar vetëm në fitimin nga eksporti. Këto vende nuk kanë mjete për ta përpunuar naftën e tyre, për të shfrytëzuar komplekset e veta industriale, apo për të zhvilluar industrinë e veta. Më e keqja, disa popuj mysliMAN nuk posedojnë fare mjete për eksplorimin dhe studimin e burimeve të veta natyrore apo për zbulimin dhe nxjerrjen e tyre. Eksplorimet e ndërmarra nga kompani të huaja kanë nxjerrë në pah se vende të tjera mysliMAN kanë rezervate nafte dhe gazi, por ato nuk përfitojnë nga burimet e veta.

Natyrisht, shfrytëzimi jo efektiv i burimeve natyrale nuk është problemi i vetëm ekonomik i botës Islamike. Sidoqoftë, zgjidhja e këtij problemi mund ti paraprijë procesit të zgjidhjes së shumë problemeve tjera. Ekonomia e popujve Mysliman përfshinë dallime si në strukturë ashtu edhe në funksionim. Disa ekonomi të popujve varën nga burimet minerale, siç janë anëtarët e OPEC-ut, derisa popujt tjerë varën nga bujqësia. Këto dallime, deri diku, janë reflektuar edhe në strukturën e tyre shoqërore, sikurse janë dallimet në shkallë të lartë në mes të popullsisë rurale dhe asaj urbane. Zhvillimi plotësues i marrëdhënieve dhe ndihma e tërthortë ndër vete në fusha të caktuara të ekspertizës mund ti transferoj këto dallime në burime të pasurimit. E tëra kjo do të ishte e mundur me Unionin Islamik.

Ndërmarrjet e përbashkëta dhe projekt partneritete do të jenë një hapë i rëndësishëm në drejtim të duhur, të cilat do tua bënin të mundur vendeve të përfitojnë nga përvojat e njëri tjetrit dhe të hyrat nga këto projekt investime do të ishin në dobi të të gjitha vendeve pjesëmarrëse. Një ndihmë e tillë e përbashkët financiare është në përputhje me moralin Islam, për tu dalë në ndihmë nevojtarëve dhe të pasurit e ndjenjës së përgjegjësisë shoqërore janë karakteristika të rëndësishme të cilat Myslimanët orvatën ti arrijnë. Shumë vargje Kuranore ia përkujtojnë Myslimanëve të kujdesen për nevojtarët.



Bashkëjetesa e brendshme e shoqërisë duhet të zgjerohet në marrëdhënie ndërkombëtare. Përderisa bashkëpunimi ndërkombëtar brenda partneritetit nuk mund të jetë i një-anshëm, punësimi dhe niveli i të hyrave do të rritet në gjithë shtetet. Për shembull, njëri shtet do të prodhojë vaj ndërsa një tjetër do ta përpunojë atë, ndërsa vendet që varën nga bujqësia do të kishin mundësi ta importonin ushqimin që u nevojitet nga vendet e zhvilluara bujqësore. Nevojat e vendeve me fuqi-punëtore të mangët do të mbulohen nga një vend tjetër Islamik, derisa vendet e pasura do të mund të investonin aty dhe tu ndihmojnë vendeve me fuqi-punëtore të cilat nuk kanë vende të mjaftueshme të punës për njerëzit e tyre. Kjo do të ishte në dobi të të gjithëve. Shkëmbimi i aftësive dhe përvojave do ta shtonte prosperitetin, dhe kështu të gjithë Myslimanet do të përfitonin nga zhvillimet teknologjike.

Ndërmarrjet e përbashkëta të cilat njëmendësojnë bashkimin e mundësive dhe mjeteve të botës Islamike do tua mundësojnë Myslimaneve prodhimin e prodhimeve hi-tech. Tregu i përbashkët Islamik do tu mundësonte prodhimeve Myslimane që të tregtohen edhe në vendet tjera Myslimane pa kurrfarë pengese doganore, kuote, si dhe pengesa tjera ndër-kufitare. Tregu do të zgjerohej, shkëmbimi tregtar dhe eksportimi nga të gjithë shtetet Myslimane do të rritej, industrializimi do të përshpejtohej si dhe zhvillimi ekonomik do të sillte progres në teknologji. Standardi i jetesës dhe pasuria e popujve Mysliman do të shtohet, ndërsa mosbarazimet ndër ta do të zhdukeshin. Disa marrëveshje të tregtisë së lirë tanimë janë vendosur në mes të shteteve të Gjirit, Brezit të Paqësorit, dhe Afrikës së Veriut. Marrëveshje të tregtisë të nënshkruara nga Turqia tani më janë në veprim në botën Islamike. Bashkëpunimi bilateral ekziston në disa regjione; sidoqoftë, shtrirja e tyre duhet të zgjerohet. Bashkëpunime të tilla do të mbrojnë të drejtat dhe interesat e të gjithë popujve Mysliman dhe do tu paraprijnë të gjithëve në zhvillimin e tyre – një rezultat nga i cili të gjithë do të nxirrnin përfitime më të mëdha se sa nëse nuk do të bashkëpunonin me njëri tjetrin.

E tëra kjo mund të realizohet vetëm nën një autoritet qendror udhëheqës dhe bashkëpunimi. Që një gjë e tillë të arrihet do të duhej që popujt Mysliman ti

përvetësojnë vlerat Kuranore si dhe praktikën (synetin) e Muhamedit (Paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), ose, me fjalë të tjera, nëse ata i përvetësojnë kulturat Islamike. Unioni Islamik duhet ti paraprijë drejt ngjalljes së kësaj kulture, si dhe të rezultojë me një bashkëpunim politik dhe ekonomik.

Bashkëpunimi i tërthortë ndër Mysliman, si pjesë e kodit Islamik, duhet të mbështetet nga të gjithë Myslimanët, sipas urdhrave të Zotit njerëzit duhet të përmbahen nga koprracia dhe të kujdesën për nevojtarin dhe ta ndihmojnë njëri-tjetrin. Në të vërtetë, të varfërve u është përcaktuar një pjesë nga pasuria e besimtarëve (Kuran, 15:19). Ashtu siç është shpallë në Kuran:

Të ndershmit dhe të pasurit nga ju, të mos betohen se nuk do t'u japin të afërmve, të varfërve dhe atyre që për hir të All-llahut lanë vendlindje e tyre, po le t'ua falin (gabimin) dhe mos t'ua zënë për të madhe. A nuk dëshironi që All-llahu t'u falë. All-llahu falë dhe mëshiron shumë. (Kuran, 24:22)

Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngushtë nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë All-llahu, e All-llahu nuk ngarkon askënd, vetëm aq sa i ka dhënë; mirëpo pas vështirësisë All-llahu sjellë çlirim (begati). (Kuran, 65:7)

Zoti ynë shpallë gjithashtu se besimtarët janë mbrojtës të njëri-tjetrit. (Kuran, 9:71). Fjala "kujdestar" bartë kuptime të atilla si shokë, ndihmëtar, mentor, dhe mbrojtës. Ajo gjithashtu shpreh rëndësinë e bashkëpunimit dhe solidaritetit ndërmjet popujve Myslimane. Bashkëpunimi i cili do rrjedhë nga ky vetëdijesim vëllazëror ndër popujt Myslimane do të sjellë përparim dhe bollëk tek Myslimanët si dhe do ta çrrënjos varfërinë, një problem i preokupues i botës Islamike. Shoqëritë që i përmbahen vlerave të Kuranit nuk do të përjetojnë krizë, skamje, dhe varfëri. Myslimanët do të zhvillojnë popujt e tyre duke iu përmbajtur politikave racionale dhe afat-gjate, duke ndërtuar marrëdhënie të mira me vendet dhe popujt tjerë, duke e vlerësuar tregtinë dhe zhvillimin dhe duke mësuar nga përvojat e kulturave tjera. Kështu ishte edhe nga historia si dhe, me vullnetin e Zotit, dhe nën udhëheqjen e unionit Islamik do të jetë sërish.

"Për to blerë punimet e Harun Jahjes, ju lutmei vizitoni www.bookglobal.net."

1- Demetrios Yiokaris, Islamic League Study Guide-1997, United Nations: Study Guides. Online at: www.vaxxine.com/cowac/islmcgl1.htm.

2- "Islamic Countries have the resources to match the west, scientist", Arabic News.com, 28 May 2000. Online at: www.arabicnews.com/ansub/Daily/Day/000628/2000062848.html.

3- Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The Gulf and Transition: Executive Summary and Major Policy Recommendations" (October 30, 2000).

4- Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The US Military and the Evolving Challenges in the Middle East" (March 9, 2002), 3.

5- Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The US Military and the Evolving Challenges in the Middle East" (March 9, 2002), 3.

6- Anthony H. Cordesman and Arleigh A. Burke, "The US Military and the Evolving Challenges in the Middle East" (March 9, 2002), 4.

7- Jim Nichol, "Central Asia's New States: Political Developments and Implications for U.S. Interests," CRS (Congressional Research Service) Issue Brief for Congress (June 13, 2003). Online at: www.ncseonline.org/NLE/CRS/abstract.cfm?NLEid=16833.

<https://www.harunyahya.info/sq/artikujt/cfarE-ndikimi-do-tE-ketE-bashkimi-islamik-nE-zhvillimin-ekonomik>